



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

**VENDIM**

*Nr. 118 Datë 22.08.2012*

**PËR  
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË  
“ALBPETROL” SH.A NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË  
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9946, date 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 14, pika 1, germa “a”, si dhe të “Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror.” nenit 4, pika 1, germa “a”; nenit 5; nenit 8; neni 9 pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, germa “a” dhe nenin 11 dhe 12 pika 1, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 09, date 11.02.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.08.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ALBPETROL“ sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “ALBPETROL” sh.a, për liçensimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë “ALBPETROL sh.a, në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30 vjeçar, sipas liçensës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Shoqëria “ALBPETROL” sh.a, do të paguajë tarifën e aplikimit në momentin e miratimit të saj nga ERE.

3. Shoqëria “ALBPETROL” sh.a, detyrohet të zbatojë të gjitha detyrimet që burojnë nga Ligji nr. 9946, datë 30.06.2008, “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe kushteve të liçensës bashkëlidhur këtij vendimi.
  
4. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**